



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.593/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevci kryesues, Rustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtarë, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga Besim Qestaj me vendbanim në Zvicër, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), lidhur me mos përfshirjen në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahen me datën 17 tetor 2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 02.09.2021, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet i bazuar apeli Anr.593/2021 i paraqitur nga Besim Qestaj me vendbanim në Zvicër, Detyrohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, që apeluesin ta regjistroi si votues në listën e votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, që do të mbahen, me datën 17 tetor 2021.

A r s y e t i m

Me datën 01.09.2021 PZAP-i, ka pranuar një apel nga Besim Qestaj me vendbanim në Zvicër në të cilin pretendon se brenda afatit kohor ka aplikuar në KQZ dhe ka pranuar njoftimin automatik së është regjistruar si votues jashtë Kosovë por përkundër kësaj nuk gjendet në listat e votuesve andaj ka kërkuar që të përfshihet në listat e votuesve jashtë Kosovës pas që i plotëson të gjitha kriteret e parapara për aplikim.

Parashtruesi i apelit, apelit i ka bashkangjitur emailin nga KQZ, formularin e aplikimit për Besim Qestaj dhe dokumentin identifikuese/ letërnjoftimin.

Me datë 01.09.2021 PZAP, ka parashtruar kërkesë për përgjigje pranë KQZ, me të cilën ka kërkuar që të njoftohet lidhur apelin e parashtruar nga pala ankuuese deri më datë 01.09.2021 në ora 18:00.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve brenda afatit kohor ka paraqitur përgjigje në kërkesë në të cilën ka theksuar se aplikacioni i apeluesit Besim Qestaj është dërguar brenda afatit të periudhës së aplikimit për regjistrim me datë 18.08.2021 në ora 20:09 së bashku me dokumentet e identifikimit e të cilat nuk janë shtypur për arsye teknike andaj KQZ konsideron se dokumentacioni i dërguar i përmbush kushtet për përfshirjen në listën e votuesve jashtë Kosovës.

Paneli pasi që shqyrtoi apelin konstatoi:


Apeli është i bazuar

Paneli, konstatoi se nga shkresat e lëndës dhe përgjigjja në ankesë e KQZ-së, në të cilën pohojnë se aplikuesi Besim Qestaj, ka dorëzuar të gjitha dokumentet që vërtetojnë se i njëjti në kuptim të nenit 5.1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme/Lokale (LZP), i plotëson kushtet për tu regjistruar në Listën e Votuesve Jashtë Kosovës, prandaj në bazë të nenit 118.1 të LZP-së lidhur me nenin 10.7 të Rregullës Zgjedhore nr. 2/2015, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr.593/2021 më datën 02.09.2021

Kryesues i Panelit
Adnan Komushevi



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa, sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.